Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**08.04.2025**	**30.04.2025**	**2025/0237**
Eksperti Teknik **Enver Bytyçi**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **15.04.2025**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.04.2025, **OE "SEMAKS SH.P.K."-** Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: **2025/0237,** kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi I projektit te integruar te Bulevardit te qytetit Gjilan**" me nr. të prokurimit: **"651-25-644-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **18,000,000.00** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca
Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje
Neni 45 - Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve të një kontrate publike të përfshirë nga një njoftim paraprak
Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional

Te nderuar,

Me date 18.03.2025 është publikuar njoftimi për kontrate ku ne si OE kemi shpreh interesim për pjesëmarrje, e kemi analizuar ne detaje këtë projekt dhe kemi vërejte se ka shkelje te dispozitave te LPP-se dhe diskriminim tek kërkesat e dosjes se tenderit saktësisht Kapaciteti teknik dhe profesional:

KERKESA 1:

Kërkesa 1. Operatori ose grupi i OE duhet te ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses kontrata per projekte te ndertimit te natyres se ngjashme ne vlere prej 15.000,000.00 euro, ndersa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet te janë pune ne projekte te ndertimit te nenkalimeve. Ne rast te grupit, lideri duhet te kete se paku 2 referenca ne ndertimin e projekteve te nenkalimeve.

Kjo kërkesë duhet te korigjohet sepse kërkesa per pune te nënkalimeve 6 milion eshte diskriminuese sepse sikurse punet e nënkalimeve te ngjashme jane edhe punët e rrugeve dhe punët ndërtimore te objektet ose parkinget e ndryshme andaj kërkojmë që te largohet kriteri per nënkalime sepse punët jane te ngjashme sikurse tek punet e tjera. Pra edhe puna në nënkalime hyn në kuadër të punëve të ndërtimit, prandaj kjo kërkesë është shumë kufizuese dhe duhet të ndryshohet me qëllim të hapjes së konkurrencës.

KERKESA 2:

Kërkesa 5. OE duhet të jetë i certifikuar me çertifikata si në vijim:
a)OE duhet te ofroj certifikaten e qendrueshmerise se performances dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikaten e karakteristikave te produkteve 6.8m, 12.8m per shtylla konike ndriqimit.

Kjo kërkesë është diskriminuese sepse këto karakteristika i ofrojnë kompanitë qe janë prodhues të shtyllave, prandaj prodhuesit janë të certifikuar me këto standarde e nuk ka arsye që të jetë i certifikuar edhe operatori ekonomik, por e rëndësishme është që te gjitha materialet qe do të përdoren do të ofrohen sipas kërkesave te projektit dhe te miratuara nga menaxheri i projekti.
Mbi këtë bazë vlerësojmë se duhet të largohet kjo kërkesë pasi që është shumë favorizuese dhe njëkohësisht kufizuese për shumë OE.

Certifikata duhet te jete ne emer te OE i cili aplikon ose duhet te kete autorizim per certifikaten ne fjale.
Këto certifikata janë plotësisht të panevojshme që ti posedojnë OE, madje këto certifikata nuk ka nevojë që të ofrohen as nga një autorizues apo distributor, pasi që me standardet në fuqi secili prodhues që i prodhon shtyllat përkatëse i nënshtrohet rregullativave ligjore dhe plotësimit të standardeve përkatëse.

b) OE duhet te ofroj certifikaten per kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dhe nderpreres per orman me standardin IEC 60947-3 2020.
Gjithashtu edhe kjo kërkesë është diskriminuese sepse keto certifikata i ofrojn kompanit qe prodhojn keto materiale dhe te gjitha materialet qe perdoren do te jene

sipas kerkesave te projektit dhe te miratuara nga menaxheri i projekti. Nuk duhet kërkuar standarde nga ofertuesi, pasi që ky tender ka të bëjë me ndërtim e jo me shtylla ose materiale elektrike, prandaj në këtë rast çdo herë ndodh bashkëpunimi me kompanitë e specializuara në fushat përkatëse, e të cilat i mbajnë përgjegjësitë për furnizimet apo shërbimet të cilat i ofrojnë ato.
Kërkojmë që të larohet kjo kërkesë nga dosja e tenderit.

KERKESA 3:

Kerkesa 4. Lista e paisjeve
Operatori Ekonomik duhet te posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Deshmia 4. Lista e pajisjeve
OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit e nenshkruar dhe vulosur nga OE.
Per automjetet qe nuk regjistrohen nga pika (1-21) Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, te gjitha ato mjete qe paraqiten me fature te blerjes duhet te kene te bashkangjitur edhe transaksionin bankar.
Per automjetet qe regjistrohen nga pika (22-35) Librezat e qarkullimit me validitet.
Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronesine OE duhet te ofroj marreveshjen per marrjen me qira te pajisjeve me deshmite sipas kerkeses me larte. Marreveshja duhet te jete ne emer te ketij projekti me validitet te kohezgjatjes te ketij prjekt e nenshkruar dhe vulosur nga te dyja palet.

ANEKSI 7. Lista - PAJISJET DHE MEKANIZIMI I NEVOJSHËM

Vërejtje: Mbetet obligim i Kontraktorit që, përveç pajisjeve dhe makinerive të listuara më poshtë, të sigurojë edhe pajisje dhe makineri tjera për të cilat kontstohet (nga Autoriteti Kontraktues apo vet Kontraktori) se janë te nevojshme për ekzkekutimin e punëve sipas sasisë, cilësisë dhe dimaikës së kontraktuar.

PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKTIN ME TITULL:

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	
8	Gjysemrimorkio speciale me 2 pompa per debllokimin e kanalizimit dhe zbrasjen e pusetave me presion min. 200 bar me kapacitet 5000 litra. **Kjo pajisje eshte e panevojshme dhe diskriminuese sepse ska pozicion ne paramase per kete paisje sepse ketu kemi te bejm me ndertim dhe jo mirëmbajtje te projektit. Nuk ka në paramasë një pozicion për debllokim të kanalizimeve prandaj kjo kërkesë është plotësisht e pa nevojshme në këtë aktivitet të prokurimit.**	Min 1 cope	

16	Vinq hidraulik i destinuar per ngarkimin dhe shkarkimin e automjeteve **Kjo pajisje eshte e panevojshme dhe diskriminuese sepse ka edhe menyra tjera per ngarkim dhe shkarkim te automjetev.**	Min 1 cope	
17	Vinq -ashensor me konstruksion metalik per bartjen dhe ngritjen e materialeve elektromotor, me trupa te ashensorit deri ne 40m **Kjo pajisje eshte e panevojshme dhe diskriminuese sepse kjo lartesi 40 m nuk dihet se per qka do te perdoret ku ne shesh nuk kemi pozicion ne paramase për këtë lartësi. Për neve është e paqartë se në cilin vend do të ketë ngritje të materialeve deri në 40 m.**	Min 1 cope	
18	Instrument per certifikim dhe testim te kabllove (Multimates TESTPRO CV100-K50 COPPER CERTIFICATION KIT) **Kjo pajisje eshte e panevojshme dhe diskriminuese sepse këto instrumente i kanë kompanitë e specializuara në këtë fushë, ndërsa OE pastaj mund ti kontraktojnë këto kompani për këto shërbime. Ky tender ka të bëjë me ndërtim dhe normalisht që këtu ofertojnë kompanitë e ndërtimit por që normalisht ato nuk mund ti posedojnë edhe instrumentet për certifikim dhe testim të kabllove.**	1 cope	

19	Makine sharre me shirit horizontal hidraulike per prerjen e celikut ne forma kendore **Kjo pajisje eshte e panevojshme dhe diskriminuese sepse ska pozicion ne paramase per kete paisje. Përderisa nuk parashihet të kryhet ndonjë punë me këtë pajisje atëherë duhet ët largohet si kërkesë kjo makinë sharre.**	Min 1 cope	
26	Automikser vetngarkues per prodhimin e betonit **Kjo makineri mund te jete edhe pa regjistrim sepse ka me u përdor vetëm brenda punishte, prandaj nuk duhet të kufizohet konkurrenca, kërkojmë që të ndryshohet kjo kërkesë.**	Min 1 cope	
27	Kamion kiper me kran gjatesia e kranit min 20m, Mjeti duhet te posedoj pelqim ose atest **Atesti ose pelqimi per kete kamion është kërkesë absurde dhe me këtë kërkesë kemi favorizim ekstrem të një kompanie e cila ka mundur të përgatitet që më herët për këto kërkesa , prandaj**	Min 1 cope	

	kërkojmë që të largohet kjo kërkesë plotësisht e panevojshme.		
28	Gjysem Rimorkio kompresor min 1.5T **Kjo pajisje mund te jete edhe pa regjistrim sepse ka me u përdor vetëm brenda punishte, prandaj kërkojmë që të lejohet edhe pa regjistrim.**	Min 1 cope	
30	Traktor me fshise per pastrim. Max 1.5T **Kjo makineri eshte e pa nevojshme sepse ketu ka punime dhe nuk ka mirembajtje per pastrime, ndërsa kjo faze fillon pas ndertimit te sheshit?**	Min 1 cope	
31	Xhip transportues me korpe me 2 dyer me sistemin e transmisionit per mundesi terheqje me te gjitha rrotat 4x4. Mjeti duhet te posedoj atestet **Fillimisht ky xhip i kërkuar nuk ka lidhje me asnjë pozicion ne paramasë, prandaj kërkojmë te largohet kjo kërkesë, e po ashtu atestet nuk kanë të bëjnë fare me këtë natyrë të prokurimit.**	Min 1 cope	
32	Furgon special per punime elektrike me 2 dyer **Për punime elektrike ka edhe mënyra te tjera të punës e nuk do të thotë se është e domosdoshme që të posedohet makine speciale andaj kërkojmë që të ndryshohet kjo kërkesë.**	Min 1 cope	

33	Dumper me goma vetshkarkues min 5T **Kjo makineri mund te jete edhe pa regjistrim sepse ka me u përdor vetëm brenda në punishte, si dhe mund te jete me kapacitet me te vogël se sa 5T, prandaj kërkojmë që të ndryshohet edhe kjo kërkesë.**	Min 1 cope	

34	Luge ngarkuse me fshesa **Kjo luge ngarkuese me fshesa e kerkuar nuk ka lidhje me as nje pozicion ne paramasë, prandaj kërkojmë që të largohet si kërkesë.**	Min 1 cope	
35	Luge ngarkuse me pirun dhe fshesa **Edhe kjo luge e kërkuar nuk ka lidhje me asnje pozicion ne paramasë, prandaj kërkojmë që te largohet sepse është plotësisht e panevojshme.**	Min 1 cope	

Kjo liste e pajisjeve dhe makineritë e kërkuara janë diskriminuese për shumë OE te interesuar për të marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, sepse pajisjet dhe makineria e kërkuar nuk kanë lidhshmëri me natyrën dhe qëllimin e projektit dhe pozicioneve në paramase, andaj kërkojmë nga AK që këto kërkesa të korrigjohen dhe një pjesë të largohen krejt sepse janë te panevojshme dhe se shpien drejt favorizimit të një kompani të caktuar dhe mundësisë së keqpërdorimit të buxhetit.
Janë kërkuar disa pajisje sikur të jetë tenderi për ndonjë projekt me elektrikë, e disa pajisje janë kërkuar që nuk kanë fare të bëjnë me ndonjë pozicion, prandaj këto duhet ët ndryshohen me qëllim që të ketë konkurrencë të hapur.

KERKESA 4:

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN ka publikuar tenderin ne fjale me date 18/03/2025, ku sipas dosjes se tenderit afati i fundit per dorëzimin e tenderëve është data 07/04/2025. Me rastin e përcaktimit te afatit te fundit per dorëzimin e tenderëve, AK ka vepruar ne kundershtim me Nenin 44 dhe Nenin 45 te LPP. Sipas dispozitave te Nenit 44 te LPP, ne rastet e kontratave me vlere te madhe, AK duhet qe te mbaje tenderin te hapur ne nje afat jo me pak se 40 dite. Ndërsa ne rastet kur ka njoftim paraprak, atëherë tenderi duhet te jete i hapur ne një afat jo me pak se 24 dite. Afati i fundit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues është me i shkurtër se 40 dite, dhe me i shkurtër edhe se 24 dite.
Autoriteti kontraktues nuk ka pas parasysh faktin se afatet për ofertim të janë në harmoni me natyrën dhe qëllimin e projektit gjithnjë duke pasur parasysh kërkesat e shumta që duhet të plotësohen për të përgatitur një ofertë serioze.

Kërkojmë nga OSHP-ja qe të detyrojë AK-së të korrigjojë dosjen e tenderit dhe të hiqen disa kërkesa ne te kundërtën do te veprojmë sipas ligjeve ne fuqi dhe do te ndjekim rrugën tone ligjore edhe ne instanca me te larta.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit". Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bien në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku shkruan qartë se "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar

rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomiko financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik).

Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së- qëllimi i LPP-së, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE: SEMAKS SH.P.K. me NUI:.812150332 me seli në .Prizren.**

II. **Obligohet AK: KUVENDI KOMUNAL- GJILAN qe të bëj korrigjimin e dosjes konform dispozitave të LPP-së.**

KRITERET PËR VLERËSIM

/

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

/

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

/

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

/

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **SEMAKS SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit me titull: "**Ndërtimi I projektit te integruar te Bulevardit te qytetit Gjilan**" me nr. të prokurimit: **"651-25-644-5-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.**

Ankesa është parashtruar në fazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Rrjedhimisht, duke qenë se Operatori Ekonomik ankues është i pakënaqur me refuzimin e kërkesës i njëjti parashtron ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues gjatë përpilimit të kërkesave në dosje të tenderit ka shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,7,44,45,69.

Pretendimi i OE ankues:

OE ankues pretendon se kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale lista e projekteve të përfunduara janë diskriminuese, andaj kërkoj të hiqet pjesa e punëve të nënkalimeve.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në dosje të tenderit të korrigjuar me datë 26/03/2025 ka përcaktuar si më poshtë:

Kërkesa 1. Operatori ose grupi i OE duhet te ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses kontrata per projekte te ndertimit te natyres se ngjashme ne vlere prej 15.000,000.00 euro, ndersa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet te jene pune ne projekte te ndertimit te nenkalimeve. Ne rast te grupit, lideri duhet te kete se paku 2 referenca ne ndertimin e projekteve te nenkalimeve.

Dëshmia 1. Një listë e konratave e nënshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontrates, vlerën e kontrates, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara, Nëse kontrata me reference është me kompani private te dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është pëfundu pagesa). Referencat apo pranime teknike duhet te jene ne 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Rrjedhimisht, bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 26.10 definon se AK

26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se,ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE.

Gjithashtu, bazuar edhe në neni 69 par.1 të Ligjit për Prokurim Publik gjithashtu Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 25 par. 13:

Citat:

"*Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë që në përputhje me nenin 69 të LPP-së, në të kaluarën ka përfunduar kontrata të një natyre të ngjashme me një vlerë të caktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila* ***nuk mund të caktohet më shumë se 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës.*** *Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar 52 të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose së bashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet qe kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlere*"

Ekspertja sqaron se, AK sa i përket vlerës minimale 15,000,000.00 euro karshi vlerës së parashikuar, **nuk e tejkalon 1.5 herë, d**he në rastin konkret, marrë parasysh natyrën e projektit dhe punëve të cilat do të realizohen gjithashtu edhe për pjesën e nënkalimit, atëherë në mënyrë që kontrata dhe projekti të realizohet me sukses kërkohet përvoja e operatorit ekonomik gjegjësisht Liderit, i cili përfaqëson grupin dhe gjithashtu siguron se Lideri të përmbushë pjesën e kërkesave me qëllim që të përmbushet realizimi i kontratës. Andaj AK ka përpiluar kërkesën në harmoni me nenin 25.13 dhe 26.10 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

1		**REKAPITULLIM I PERGJITHSHEM**	
2		**Përshkrimi i pozicionit**	**Shuma**
3	1	**OBJEKTI GARAZHUES (Rikapitulimi I)**	
4	2	**NËNKALIMI (Rikapitulimi 2)**	
5	3	**PROJEKTI I SHESHIT (Rikapitulimi3)**	
6		**TOTALI I PERGJITHSHEM**	

Pretendimi i dytë i OE ankues:

Kriteri 9.1 dhe 9.2 kërkesa nr.5 një ***a)OE duhet te ofroj certifikaten e qendrueshmerise se performances dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikaten e karakteristikave te produkteve 6.8m, 12.8m per shtylla konike ndriqimit.***

b) OE duhet te ofroj certifikaten per kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dhe nderpreres per orman me standardin IEC 60947-3 2020.

Deshmia 5. a)Certifikata duhet te jete ne emer te OE-se, autorizim ose marreveshje me ndonje kompani e cila posedon autorizimin per kete certifikate. Certifikata duhet te jete me validitet.

b) Certifikata duhet te jete ne emer te OE ose duhet te kete autorizim nga ndonje kompani e cila eshte distributor per shitjen e ketyre produkteve. Certifikata duhet te jete me validitet.

Kjo kërkesë është diskriminuese sepse këto certifikata i ofrojnë kompanitë që prodhojnë këto materiale dhe të gjitha materialet që përdoren do të jenë sipas kërkesave të projektit dhe të miratuara nga menaxheri i projektit. Nuk duhet kërkuar standarde nga ofertuesit, pasi që ky tender ka të bëjë më ndërtim e jo me shtylla materiale elektrike, prandaj në këtë rast çdo herë ndodhe bashkëpunimi me kompanitë e specializuara në fushat përkatëse, e të cilat i mbajnë përgjegjësitë për fudnizimet apo shërbimet të cilat i ofrojnë ato. Kërkojmë që të largohet kjo kërkesë nga dosja e tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Eksperti teknik vlerëson se certifikatat e kërkuara janë specifike për prodhues të shtyllave të ndriçimit dhe materialeve elektrike siç janë cekur në kërkesë. Vlen të theksohet se tek punët ndërtimore të elektrikes, të gjitha materialet duhet të përmbajnë certifikimet në pajtim me legjislacionin në fuqi, normave dhe standardeve relevante për natyrën dhe fushëveprimin e punëve dhe te materialeve te caktuara.

Kërkesat e përshkruara i përkasin specifikimeve teknike për materialet sipas kërkesës, gjatë realizimit të punëve ndërtimore të elektrikes duhet të kenë kontroll të cilësisë së materialeve të mbështetura me certifikatat përkatëse dhe në mënyrë të vazhdueshme duhet të verifikohen gjatë procesit të menaxhimit të projektit. Duke marrë parasysh faktin se certifikimet/standardet e kërkuara janë për produktet ndërtimore, këto duhet të vërtetohen gjatë fazës së implementimit në pajtim me përshkrimin dhe

projektin kryesor, kërkesat e tilla në këtë fazë janë jo relevante, vetëm se kufizojnë konkurrencën duke ndikuar drejtpërdrejt në procedurën e prokurimit.

AK duhet të korrigjojë kërkesën pasi që certifikatat e kërkuara janë të panevojshme në këtë fazë.

Eksperti teknik konsideron se pretendimi ankimor 2 është i bazuar.

Pretendimi i tretë i OE ankues:

OE ankues pretendon se kërkesa për pajisje është diskriminuese duke kontestuar pajisjen e Aneks 7 me numrat: 8;16;17;18;19;26;27;28;30;31;32;33;34;35, për arsye se, këto pajisje/makineri të kërkuara nuk kanë lidhmëri me natyrën dhe qëllimin e projektit dhe pozicioneve në paramasë, andaj kërkojmë nga AK që këto kërkesa të korrigjohen dhe një pjësë të largohen krejt sepse janë të panevojshme dhe e shpien drejtë favorizimit të një kompanie të caktuar dhe mundësi së keqpërdorimit të buxhetit. Janë kërkuar disa pajisje sikur të jetë tender për elektrikë, e disa pajisje janë kërkuar që nuk kanë fare të bëjnë me ndonjë pozicion, prandaj këto duhet të ndryshohen me qëllim që të ketë konkurrencë të hapur.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti teknik e ka analizuar të gjithë listën e pajisjeve dhe konstaton se ne dosjen e tenderit janë kërkuar gjithsejtë 35 lloje të pajisjeve dhe makinerive me të cilat do të realizohet projekti.

Eksperti sqaron se çdo projekt që hartohet për ekzekutim përmban metodologjinë e punës, ku ndër të tjera përcaktohen afatet kohore dhe resurset e projekti. Konform organizimit dhe teknologjisë së ndërtimit, metodologjisë së punës dhe afateve kohore përcaktohen edhe angazhimet e stafit të nevojshëm dhe makinerisë së domosdoshme për realizimin e aktiviteteve të punëve ndërtimore dhe projektit. Bazuar në këto analiza vlerësohen edhe pajisjet dhe makineritë minimale të domosdoshme për realizimin e projektit. Duke u bazuar edhe në përgjigjet e AK në kërkesën për rishqyrtim nuk mund të theksohet se ekzistojnë këto plane dhe dokumente të projektit, andaj eksperti teknik do të vlerësoj duke u bazuar në fushëveprimin e projektit dhe përshkrimit të pajisjeve të kërkuara.

Disa nga pajisjet e kërkuara janë subjekt i pikës ankimore nga OE dhe në vazhdim do të përshkruhet vlerësimi i tyre sipas numrit rendor të pajisjes ne listën e bashkëngjitur nga AK –Aneksi 7.

Pajisja nr. 8

Gjysemrimorkio speciale me 2 pompa per debllokimin e kanalizimit dhe zbrasjen e pusetave me presion min. 200 bar me kapacitet 5000 litra.

OE ankues kërkon qe kjo pajisje të largohet nga DT pasi qe në asnjë pozicion të projektit nuk përfshihet pajisja në fjalë.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti vlerëson se ne baze te përshkrimit te punëve kjo lloj pajisje nuk gjen përdorim ne projektin ne fjale dhe është e panevojshme. Nëse AK ka vlerësuar se kjo pajisje është e nevojshme duhet të ketë edhe pozicionet e punëve ndërtimore të cilat ndërlidhen me shfrytëzimin e pajisjes. Në përgjigjen e dhënë nga AK është vlerësuar se pajisja në fjalë shërben për debllokimin e gypave në kyçje së rrjetit të ri të kanalizimit, gjë që ky pozicion mungon në paramasë dhe nuk ka se si të realizohet. AK duhet te

korrigjoj dosjen e tenderit pasi që pajisja është e panevojshme.

Pretendimi për pajisjen nr.8 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 16

Vinq hidraulik i destinuar per ngarkimin dhe shkarkimin e automjeteve

OE ka kërkuar qe kjo pajisje të largohet nga kërkesa pasi që ka mënyra tjera të ngarkim dhe shkarkim të automjeteve.

AK në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se është menduar për ngarkim dhe shkarkim të materialeve ndërtimore. Dhe mjafton që të jetë një vinç hidraulik për ngarkim dhe shkarkim, AK do të pranoj këtë kërkesë.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se kërkesa për pajisjen ne fjale është diskriminuese pasi qe ka metoda dhe mënyra të ndryshme për ngarkimin dhe shkarkimin e automjeteve. Kjo pajisje është mjaft e rrallë ne zbatim dhe një kërkesë e tillë vetëm se kufizon konkurrencën dhe orienton për OE te caktuar. Duke u bazuar në përgjigjen e dhënë nga AK, eksperti teknik konsideron se përshkrimi i pajisjes duhet të modifikohet në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të përshtatet me natyrën e punës për të cilën AK ka menduar që është e nevojshme.

AK të modifikoj kërkesën sipas përshkrimit të dhënë në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, ose te largoj pajisjen në fjale nga DT.

Pretendimi për pajisjen nr.16 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 17

Vinq -ashensor me konstruksion metalik per bartjen dhe ngritjen e materialeve elektromotor, me trupa te ashensorit deri ne 40m

OE ka kërkuar qe pajisja te largohet nga DT si e panevojshme pasi qe tek sheshet nuk ka pozicion për këtë lartësi 40m dhe nuk arrihet nga objektet qe do te ndërtohen.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se përshkrimi për pajisjen nr. 17 është kufizues dhe po ashtu lartësia deri 40 metra përkufizon një pajisje mjaft specifike. Meqenëse janë pajisje mjaft të rralla, përshkrimi i tille është kufizues, andaj AK duhet të ofroj mundësinë edhe për pajisje tjera që kryejnë shërbimet e njëjta dhe mos të kufizohet vetëm tek ky lloj i pajisjes.

Eksperti teknik vlerëson se ka makineri të ndryshme që kryejnë funksionin e njëjtë për ngritjen e materialeve në nivelet e objektit gjatë ndërtimit, siç janë vinç kullat, andaj kërkesa duhet te korrigjohet, të modifikohet dhe të krijohen mundësit edhe për përdorimin e makinerive tjera standarde për këtë lloj pune.

Pretendimi i OE ankues se pajisja nuk mund të përdoret nuk qëndron pasi që në kuadër te projektit është parapare të ndërtohet objekti i administratës qe ka një lartësi të caktuar, andaj përshkrimi i lartësisë për pajisjen deri ne 40 m është vendosur si prag maksimal dhe lejon tolerancën për të ofruar pajisje që operojnë me lartësi më të vogël se pragu maksimal.

AK të bëjë korrigjimin e kërkesës, të vlerësoj në bazë të analizës së projektit dhe të krijoj mundësinë e

përdorimit edhe të pajisjeve tjera pa e kufizuar konkurrencën.

Pretendimi për pajisjen nr.17 konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Pajisja nr. 18

Instrument per certifikim dhe testim te kabllove (Multimates TESTPRO CV100-K50 COPPER CERTIFICATION KIT)

OE ka kërkuar qe pajisja te largohet si e panevojshme pasi qe këto janë instrumente te kompanive te specializuara në këtë fushë dhe se OE mund të kontraktojnë këto kompani për këto shërbime. OE ka sqaruar se këtu kemi te bëjmë me ndërtim dhe normalisht që këtu ofertojnë kompanitë e ndërtimit dhe ato nuk mund t'i posedojnë edhe instrumentet për certifikim dhe testim te kabllove.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se në kuadër të projektit ekzistojnë punët ndërtimore të elektrikes për të cilat gjatë realizimit të tyre mund të nevojitet testime të shpejta që realizohen nga pajisje profesionale për **testimin dhe certifikimin e kabllove të rrjetit**. Instrumenti shërben për të realizuar testimet e nevojshme të kabllove dhe për te siguruar performance dhe cilësi me te mire gjate realizimit te projektit.

Pretendimi për pajisjen nr.18 konsiderohet i pa bazuar.

Pajisja nr. 19

Makine sharre me shirit horizontal hidraulike per prerjen e celikut ne forma kendore

OE e ka konsideruar si te panevojshme këtë lloj pajisje pasi qe nuk ka pozicione ne paramase ku pajisja gjen përdorimin e saj.

Përgjigje nga eksperti teknik

AK ne përshkrimin e pajisjeve ka dhënë specifika për pajisje shumë detale, shumica e përshkrimeve determinojnë procesin e punës me të cilin OE-të mund të kryejnë edhe me pajisje tjera që kanë funksion të njëjtë. Mbivlerësimi i kërkesave dhe numri i madh i pajisjeve të cilat i ka përshkruar AK kufizon konkurrencën. Eksperti teknik vlerëson se kjo pajisje varësisht prej procesit të punës të cilin e zhvillon OE mund të jetë e panevojshme, pasi që këtë lloj pune e kryen në forma të tjera, ku me zhvillimin e teknologjisë ka edhe forma më të avancuara.

AK të bëjë korrigjimin e kërkesës së DT dhe të largoj pajisjen nga kërkesat e DT.

Pretendimi për pajisjen nr.19 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 26

Automikser vetngarkues per prodhimin e betonit

OE ankues ka kërkuar qe te largohet kërkesa për librezë qarkullimi për pajisjen në fjalë meqenëse kjo makineri mund të jetë pa regjistrim sepse përdoret vetëm brenda punishtes.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se sipas ligjit për automjete specifikohet që mjetet motorike rrugore të dedikuara për përdorim në kantiere ndërtimi, janë të përjashtuara nga homologimi dhe nuk ka nevojë të

regjistrohen për qarkullim rrugor. Meqenëse kjo pajisje nuk merr pjese në trafikun rrugor dhe se operimi i saj është në vend ndërtim ajo mund të bartet me pajisje transportuese për makineri dhe nuk ka nevojë për librezë qarkullimi.

Kërkesa për të pasur librezë qarkullimi për këtë pajisje duhet të largohet.

Pretendimi për pajisjen nr.26 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 27

Kamion kiper me kran gjatesia e kranit min 20m, Mjeti duhet te posedoj pelqim ose atest

OE nuk është pajtuar me kërkesën që AK ka kërkuar pëlqim ose Atest duke e konsideruar si favorizim për OE të caktuar.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se përshkrimi i kërkesës që pajisja duhet të posedoj pëlqim ose atest është i paqartë pasi që nuk dihet çfarë lloj pëlqimi apo atesti bëhet fjale, ky përshkrim është kufizues, diskriminues e i panevojshëm dhe duhet të largohet nga kërkesa e DT. Eksperti sqaron se makineria e cila i nënshtrohet kontrollit të rregullt teknik nuk ka nevojë për pëlqim ose atest.

Pëlqim ose Atest përmes të cilit vërtetohet funksioni në gjendje të rregullt i pajisjes, mund të kërkohet për pajisje të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit dhe regjistrimit të rregullt.

AK të korrigjoj kërkesën e DT, modifikoj dhe të largojë nga kërkesa përshkrimin **"pëlqim ose atest".**

Pretendimi për pajisjen nr.27 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 28

Gjysem Rimorkio kompresor min 1.5T

OE nuk është pajtuar për kërkesën qe pajisja te ketë regjistrim valid pasi qe kjo pajisje përdoret vetëm brenda në punishte dhe nuk ka nevojë për regjistrim.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik konsideron se kërkesa për automjetet që të kenë librezë qarkullimi valide duhet te jete ne përputhje me legjislacionin specifik. Pajisjet te cilat operimin e kane vetëm ne vend punishte nuk kane nevoje te regjistrohen.

AK të korrigjoj kërkesën dhe të largoj kriterin për librezën e qarkullimit për pajisjen përkatëse.

Pretendimi për pajisjen nr.28 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 30

Traktor me fshise per pastrim. Max 1.5T

OE e ka konsideruar si te panevojshme pajisjen, pasi qe kjo me shume ka te beje me mirëmbajtje dhe pastrim.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti vlerëson se OE ka dhënë argumentet qe kjo pajisje është e pa nevojshme, pasi qe këto janë

pune ndërtimore e jo mirëmbajtje te hapësirave publike. Pajisja nuk është relevante me natyrën e punëve ndërtimore dhe nuk duhet te jete kriter i kërkesës ne fjale, si e tillë duhet te largohet nga DT.

Pretendimi për pajisjen nr.30 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 31

Xhip transportues me korpe me 2 dyer me sistemin e transmisionit per mundesi terheqje me te gjitha rrotat 4x4. Mjeti duhet te posedoj atestet

OE ka cilësuar se pajisja e kërkuar nuk ka lidhje me asnjë pozicion në paramasë dhe ka kërkuar të largohet kjo kërkesë.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti vlerëson se pajisja në fjalë nuk ndërlidhet ne asnjë aktivitet të punës, është kërkesë e tepërt, diskriminuese dhe jep mundësinë e kufizimit të konkurrencës duke e orientuar konkurrencën tek operator ekonomik të caktuar. Automjeti i kërkuar nuk ndërlidhet me punët ndërtimore të natyrës së projektit.

AK të korrigjoj DT dhe pajisjen në fjalë të largoj nga dosja e tenderit.

Pretendimi për pajisjen nr.31 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 32

Furgon special per punime elektrike me 2 dyer

OE kërkon qe kërkesa të ndryshohet pasi që për punimet elektrike ka edhe mënyra tjera të punës dhe nuk do të thotë se është e domosdoshme të posedohet makineri speciale.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti vlerëson se punimet elektrike mund të realizohen në metoda tjera pa pasur nevojë për automjetin në fjalë kështu që pajisja e kërkuar është e panevojshme dhe nuk duhet të jetë kriter i DT.

AK të korrigjoj kërkesën e DT pasi që pajisja është e panevojshme.

Pretendimi për pajisjen nr.32 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 33

Dumper me goma vetshkarkues min 5T

OE ankues ka kërkuar qe kjo makineri meqenëse ka përdorim vetëm ne vend ndërtim mund te jete pa regjistrim dhe mund te jete me kapacitet me te vogël se 5T.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti vlerëson se sipas ligjit për automjete, makineria qe operon ne vend ndërtim nuk ka nevoje te regjistrohet, ajo mund të transportohet deri në vend punishte me makineri transportuese.

Sa i përket kapaciteti të tonazhës, eksperti konsideron se AK ka vendosur kufirin minimal të kapacitetit të pajisjes që është min. 5t, me këtë prag AK ka dhënë hapësirë për tolerancën me të cilën ofertuesit mund të ofertojnë me kapacitet më të mëdha se 5t, po ashtu është përgjegjësi e AK të vlerësoj kapacitetin që nevojitet në harmoni me kërkesat e projektit.

AK të bëjë korrigjimin e kërkesës në DT të largoj kërkesën për librezën e qarkullimit për makinerinë përkatëse.

Pretendimi për pajisjen nr.33 konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Pajisja nr. 34 dhe 35

Luge ngarkuse me fshesa

Luge ngarkuse me pirun dhe fshesa

OE ankues ka kërkuar qe këto pajisje te largohen pasi qe janë te panevojshme për natyrën e punës.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se ne bazë te fushëveprimit te projektit këto pajisje nuk ndërlidhen aspak me natyrën e punëve ndërtimore dhe si te tilla duhet te largohen nga dosja e tenderit. AK duhet të vendos kërkesat që ndërlidhen me punët ndërtimore dhe realizimin e projektit.

Arsyetimi i AK në përgjigje nuk qëndron pasi qe sipas legjislacionit ne fuqi vend ndërtimi duhet te kufizohet dhe te mirëmbahet ne mënyrë qe hapësirat jashtë vend ndërtimit te mos ndikohen nga realizimi i projektit ne fjale.

Pretendimi për pajisjen nr.34 dhe 35 konsiderohet i bazuar.

Pretendimi i katërt i OE ankues:

Kuvendi Komunal Gjilan ka publikuar tenderin në fjalë me datë 18/03/2025, ku sipas dosjes së tenderit afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është data 07/04/2025. Me rastin e përcaktimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 44 dhe 45 të LPP-së. Sipas dispozitave të nenit 44 të LPP-së, në rast të kontratave me vlerë të madhe, AK duhet që të mbajë tenderin të hapur në një afat jo me pak se 40 ditë. Ndërsa në rastet kur ka njoftim paraprak, atëherë tenderi duhet të jetë i hapur jo më i shkurtër se 24 ditë. Andaj AK nuk ka pas parasysh faktin se afatet për ofertim të janë në harmoni me natyrën dhe qëllimin e projektit gjithnjë duke pasur parasysh kërkesat e shumta që duhet të plotësohen për të përgatitur një ofertë serioze.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se, lidhur me afatin ligjor për dorëzim të tenderëve, AK në Dosje të tenderit ka specifikuar gjithashtu arsyen e përshpejtimit dhe shkurtimit të afatit për dorëzim te tenderëve, e cila bazuar në E-prokurim i bie 22 ditë nga data e njoftimit për kontratë deri në ditën e dorëzimit të tenderëve, dhe si e tillë bazuar në nenin 46 të Ligjit për Prokurim Publik – **46-Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore**, paragrafi 2 citat:

2. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor procedurat e hapura të prokurimit, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një afat të caktuar kohor për pranimin e tenderëve që është:

2.1. nëse kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se pesëmbëdhjetë(15) ditë; ose

2.2. nëse kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dhjetë (10) ditë

Dhe rrjedhimisht AK ka vepruar sipas nenit 46 të LPP-së duke shkurtuar afatin nga 40 ditë ne 22 ditë, dhe në rastin konkret ky pretendim ankimor është irelevant për shkak të zgjatjes së afatit të procedurave ankimore.

Si përfundim, bazuar në sqarimet e dhëna, rekomandohet që AK të bëjë ndryshimet në dosje të tenderit dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzim.

Shënim: Për këtë aktivitet të prokurimit gjendet edhe ankesa me nr.238/25 dhe raporti i dorëzuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **SEMAKS SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Huruglica

Enver Bytyçi